

HAMIT KABA

Instituti i Historisë/ Akademia e Shkencave e Shqipërisë
hamitkaba@yahoo.com

**TENTATIVAT E BRITANISË SË MADHE PËR TË
NORMALIZUAR MARRËDHËNIET ME SHQIPËRINË NË
DEKADAT E FUNDIT TË SHEK. XX****Abstrakt:**

Artikulli fokusohet në përpjekjet e Britanisë së Madhe për të rivendosur marrëdhëniet diplomatike me Shqipërinë në dhjetëvjeçarët e fundit të shek. XX. Për hartimin e tij autori është mbështetur në burime të ndryshme, ku spikatin dokumentet arkivore britanike, të hulumtuara në The National Archives, në Londër, arkivat shqiptarë dhe amerikanë (National Archives and Record Administration në Marryland). Karakteristikë kryesore e kësaj periudhe është qasja e re e qeverisë britanike ndaj kësaj çështjeje, e cila ndryshe nga dy dekadat pararendëse, mori e para iniciativën për të rivendosur marrëdhëniet diplomatike me Shqipërinë, dhe për të kapërcyer ngërçin e krijuar nga problemet e pazgjidhura ndërmjet të dyja vendeve. Shkaqet e qasjes së re të Britanisë së Madhe janë kërkuar e argumentuar me ndryshimet e pjesshme të politikës së jashtme të Shqipërisë pas daljes nga Traktati i Varshavës (TV), te ndryshimet e mëdha politike, që ndodhën në Europë në gjysmën e parë të viteve '70, te politika e re e SHBA-së ndaj Shqipërisë, te situata e krijuar pas ndarjes së Shqipërisë me Kinën në vitin 1978 dhe prishja e mundshme e balancave Lindje-Perëndim, dhe sidomos te roli i veçantë i Britanisë së Madhe, për ta mbajtur Shqipërinë larg afrimit të saj me BS-në dhe rikthimit në Traktatin e Varshavës. Por fleksibiliteti i qeverisë britanike nuk u shoqërua me elasticitetin e qeverisë shqiptare. Kjo e fundit mbeti “robinë” e formulave të vjetra ligjore e ideologjike dhe e urdhrave politikë partiakë.

Fjalë kyçe:

Britania e Madhe, SHBA, Shqipëria, Kina, marrëdhënie diplomatike, bisedime, incidenti i Kanalit të Korfuzit, Gjykata e Hagës, ari monetar shqiptar, Traktati i Varshavës.

Marrëdhëniet diplomatike mes Britanisë së Madhe dhe Shqipërisë për gati një çerekshkulli mbetën të ngrira dhe të pezulluara, ndonëse fillimet ishin premtuese. Qeveria britanike i ofroi njohje të kushtëzuar qeverisë së përkohshme të Shqipërisë në nëntor të vitit 1945. Njohja u bë realitet me pranimin e zgjedhjeve të 2 dhjetorit, të cilat u konsideruan “të pranueshme”.¹ Por njohja nuk u shoqërua me shkëmbimin e misioneve diplomatike, ndonëse të dyja palët caktuan ministrat përkatës. Përfaqësuesi diplomatik i Britanisë së Madhe në Beograd, më 18 maj 1946, vetëm 20 minuta pasi kishte dhënë konfirmimin për rivendosjen e marrëdhënieve diplomatike ndërmjet të dyja vendeve paraqiti një notë tërheqjeje.² Procesi u pezullua si rezultat i dy incidenteve të ndodhura në Kanalin e Korfuzit, më 15 maj dhe më 22 tetor 1946 dhe mospranimit të fajit nga Shqipëria. Rasti i dytë ishte më i rëndë, sepse dy destroyerët ‘Saumarez’ dhe ‘Volage’ u dëmtuan keqas nga shpërthimet e minave, të cilat shkaktuan 44 ushtarake të vrarë dhe 42 të plagosur.³ Qeveria shqiptare nuk e pranoi vendimin e Gjykatës së Hagës të datës 9 prill 1949, që e fajësonte Shqipërinë për shpërthimet e ndodhura në ujërat e saj territoriale, dëmtimet e anijeve dhe humbjet e jetëve njerëzore, si dhe vendimin e mëvonshëm për t’i shlyer Britanisë së Madhe shumën prej 843 947 sterlinave. Sidoqoftë, qeveria komuniste e Shqipërisë pranoi të bisedonte me qeverinë britanike për shlyerjen e detyrimeve ende pa u shpallur vendimi i Gjykatës së Hagës dhe pas dhënies së tij. Qeveria britanike nuk e pranoi propozimin e palës shqiptare për fillimin e shlyerjes së detyrimit, pa u shpallur vendimi i Gjykatës së Hagës. Bisedimet ndërmjet Behar Shtyllës dhe Eric Backett-it filluan në Paris dhe më vonë u zhvendosën në Londër në vitin 1950.⁴ Por shuma prej 40 000 £, që qeveria shqiptare u ofroi britanikëve si dëmshpërblim, që në

¹ *The National Archives and Record Administration* (më tej: NARA), RG 59, f. 2, General Record of the Department of State 1945-1949, 711.75/1-2347, “Shqipëria, deklaratë politike dhe informuese”, 23 janar 1947.

² *Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme* (më tej: AMPJ), Viti (më tej: V.) 1959, Dosja (më tej: D.) 342, fl. 4; *po aty*, V. 1946, D. B/I-1, fl. 58. Radiogram nr. 79 Rez. i Hysni Kapos, drejtuar MPJ-së nga Beogradi; *po aty*, V. 1946, D. 25. Notë verbale e ambasadës britanike në Beograd për Misionin shqiptar, të kryesuar nga Hysni Kapo, 18 maj 1946.

³ *Po aty*, V. 1980, D. 1158/1.

⁴ Ksenofon Krisafi, *Në kërkim të arit, historia e arit shqiptar të rrëmbyer gjatë Luftës së Dytë Botërore*, (Tiranë: UET Press, Dita 2000, 2008), 137-143.

fakt përbënte më pak se 5% të vlerës totale, u konsiderua si veprim ‘tallës’ nga Foreign Office (FO).⁵ Shlyerja e dëmshpërblimit, qoftë edhe me këste, sipas mendimit tim, nënkuptonte pranimin e legjitimitetit të vendimit të marrë nga Gjykata e Hagës në vitin 1949 dhe, indirekt pranimin e fajit nga Shqipëria, ndonëse zyrtarisht kjo e fundit asnjëherë nuk pranoi të konsiderohej e tillë. Dështimi i bisedimeve shënoi edhe fundin e përpjekjeve të Britanisë së Madhe për të rivendosur marrëdhëniet diplomatike me Shqipërinë, të cilat mbetën të ngrira në vitet ’50-’60.

Në pamundësi për të përfituar nga ndonjë pasuri tjetër e Shqipërisë, qeveria britanike vendosi të bllokonte arin monetar shqiptar, të grabitur nga gjermanët gjatë Luftës së Dytë Botërore. Por çështja u ndërlikua më tej kur qeveria italiane ripërsëriti pretendimet e veta për pronësinë e arin monetar, që më parë i ishte njohur Shqipërisë. Qeveria angleze e konsideroi legjitim pretendimin e Shqipërisë për arin monetar dhe mbrojti të drejtën e saj mbi pronësinë e tij. Me këtë veprim ajo shmangu deri diku pretendimin e qeverisë italiane, por ari nuk i kaloi Shqipërisë, sepse qeveria britanike e shihte atë, si të vetmen mundësi për marrjen e dëmshpërblimit të caktuar nga Gjykata e Hagës. Ari u bllokua dhe u kalua nën ruajtjen e Komisionit Trepalësh për kthimin e arit monetar, të përbërë nga përfaqësuesit e SHBA-së, Britanisë së Madhe dhe Francës.

Fundi i viteve ’40 dhe fillimi i viteve ’50 shënoi acarimin e mëtejshëm të marrëdhënieve të Lindjes me Perëndimin dhe të Shqipërisë me Britaninë e Madhe dhe SHBA-në. Këto dy vende nuk kishin më shpresë se qeveria komuniste do të ndryshonte qëndrimin ndaj tyre. Në rrugën e sovjetizimit dhe të integritit të plotë të saj në Bllokun e vendeve komuniste, udhëheqja komuniste e Shqipërisë ndiqte pa hezitim modelin sovjetik dhe urdhrat e Moskës. Por pas ndarjes së Jugosllavisë nga Bashkimi Sovjetik (BS) në vitin 1948 pozita gjeopolitike e Shqipërisë u bë më e atakueshme. Shqipëria u shndërrua një vend pa lidhje tokësore me vendet e tjera komuniste, me qëndrim armiqësor ndaj Perëndimit dhe aleatëve të tij, një vend ku kryqëzoheshin pretendimet për rrëzimin e qeverisë komuniste me pretendimet tokësore të Greqisë e të Jugosllavisë. Qeveria e Britanisë së Madhe dhe ajo e SHBA-së ngarkuan

⁵ *The National Archives*, London (më tej: TNA), Foreign and Commonwealth Office (më tej: FCO) 28/3706, JCR Gray-Eastern European and Soviet Department, “Marrëdhëniet anglo-shqiptare”, 5 dhjetor 1979.

disa institucione të specializuara, të përgatitnin e të zbatonin operacione të fshehta për rrëzimin e regjimit komunist në Shqipëri dhe në disa vende të tjera të Bllokut Komunist [Ukrainë, Poloni dhe vendet Balltike], i njohur me emrin e koduar “Rollback”.⁶ Në rrethanat e krijuara hapësirat për të negociuar e për të rivendosur marrëdhëniet diplomatike ishin mbyllur pothuajse plotësisht.

Klima e marrëdhënieve të Shqipërisë me Britaninë e Madhe njohu njëfarë përmirësimi, pas votimit të delegacionit të Britanisë së Madhe në favor të pranimit të Shqipërisë në Kombet e Bashkuara, në dhjetor të vitit 1955.⁷ Qeveria shqiptare e konsideroi të favorshme situatën e krijuar, për të rihapur temën delikate të rivendosjes së marrëdhënieve diplomatike me Britaninë e Madhe. Me iniciativën e diplomacisë shqiptare u zhvilluan dy takime ndërmjet ambasadorëve të të dyja vendeve në Beograd. Në takimin e parë të datës 28 dhjetor 1955 ambasadori britanik e pranoi parimisht propozimin, por parashtroi dy kushte: shlyerjen e dëmshpërblimeve të caktuara nga Gjykata e Hagës për incidentin e Kanalit të Korfuzit dhe sigurimin e kushteve normale për diplomatët britanikë që do të vinin në Shqipëri.⁸ Në takimin e dytë të zhvilluar më 11 shkurt 1956, ministri i Shqipërisë doli me propozimin, që çështja e dëmshpërblimeve të diskutohej pas vendosjes së marrëdhënieve diplomatike.⁹ Por, ambasadori britanik nuk ndryshoi qëndrim.

Në fund të vitit 1957, në FO ekzistonte mendimi se në këtë kohë, nuk duhej të merrej asnjë nismë për rivendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Shqipërinë. Për këtë çështje duhej të ecej në një hap me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të cilat nuk e gjykonin gjithashtu të

⁶ John Lewis Gaddis, *George F. Kennan: An American Life* (New York: The Penguin Press, 2011), 355; Peter Grose, *Operation Rollback: America's Secret War behind the Iron Curtain* (Boston: Houghton Mifflin, 2000); Stephen Dorril, *MI6, Fifty years of special operations* (London: Fourth Estate Limited Boulter 2000); Richard J. Aldrich, *The Hidden Hand, Britain, America, and Cold War Secret Intelligence* (London: John Murray, 2001, New York: Peter Mayer Publishers, 2002); Ben Macintyre, *A spy among friends, Kim Philby and the Great Betrayal* (New York: Crown Publishers, 2014); Nicholas Bethel, *The Great Betrayal: untold story of Kim Philby's biggest coup* (London: Hodder and Stoughton, 1984).

⁷ *AMPJ*, V. 1965, D. 2019, fl. 5.

⁸ *Po aty*, V. 1959, D. 239, fl. 11, “Marrëdhëniet e Shqipërisë me Anglinë”; *po aty*, V. 1960, D. 353, fl. 4, “Mbi marrëdhëniet e Shqipërisë me SHBA, Anglinë, Francën, Italinë dhe Greqinë”.

⁹ *Po aty*, V. 1959, D. 239, fl. 11, “Marrëdhëniet e Shqipërisë me Anglinë”.

nevojshme të rivendosnin marrëdhëniet diplomatike me Shqipërinë. Çështja e rivendosjes së marrëdhënieve diplomatike u ngrit sërish në Dhomën e Komuneve, në nëntor të vitit 1958 dhe në shkurt të vitit 1959, por pa rezultat.¹⁰

Konflikti shqiptaro-sovjetik (1960-1961) e shtoi interesin e FO-së dhe Departamentit të Shtetit (më tej: DSH), të cilët ndoqën një politikë më të përcaktuar ndaj Shqipërisë. FO-ja, sikurse DSH-ja e konsideroi ndarjen e Shqipërisë nga Blloku Komunist një ngjarje në favor të Perëndimit. Por duke parë se udhëheqja komuniste e Shqipërisë vazhdoi të mbetej staliniste, armiqësore ndaj Perëndimit dhe politikisht jorefraktare ndaj qëndrimeve të mëparshme, si FO-ja ashtu edhe DSH-ja u përpoqën që ta mbështesnin e ta ushqenin rolin e saj, si faktor përçarës dhe gërryes në bllokun e vendeve komuniste.¹¹ Dyshimet e ambasadorit amerikan në Jugosllavi, George Kennan, për një komplot të mundshëm të Hrushovit dhe Titos, që mund të ndikonte mbi Shqipërinë e sapondarë nga BS-ja, nuk morën vëmendjen e duhur nga Washingtoni dhe ambasada amerikane në Moskë.¹²

Ndarja e Shqipërisë me BS-në ndikoi disi edhe mbi politikën e qeverisë britanike. Në janar të vitit 1962, FO-ja korrigjoi diçka në politikën e vet ndaj Shqipërisë. Në një komunikatë konfidenciale, në lidhje me politikën që duhej të ndiqte ndaj vendeve të tilla si Shqipëria, Republika Demokratike Gjermane, Republika Demokratike e Koresë dhe Vietnami, bëhej një dallim për Shqipërinë dhe për Arabinë Saudite. FO-ja shpallte se, nuk do t'i pengonte më përfaqësuesit e saj diplomatikë, që të komunikonin direkt, apo nëpërmjet ndërmjetësve me përfaqësuesit diplomatikë të këtyre dy shteteve. Por, Ministria e Jashtme angleze i ndalonte përfaqësuesit e saj, që të përgjigjeshin direkt dhe të vendosnin për çështje të ndryshme, pa u njohur më parë me gjykimin e qeverisë së tyre.¹³ Qeveria shqiptare kishte lejuar që për qëllime turistike, shtetasit anglezë të vizitonin Shqipërinë. Sidoqoftë, interesi i diplomacisë

¹⁰ *Po aty*, V. 1965, D. 2019, fl. 5.

¹¹ Hamit Kaba, *Shqipëria dhe të Mëdhenjtë: nga Lufta e Dytë Botërore në Luftën e Ftohtë* (Tiranë: KLEAN, 2015), 231-258.

¹² John Lewis Gaddis, *George F. Kennan: An American Life* (New York: The Penguin Press, 2011), 567.

¹³ TNA, Foreign Office (më tej: FO) 371/182535, qarkore nr. 053 e Foreign Office, "Komunikime me qeveri, marrëdhëniet e të cilave me qeverinë e Madhërisë së Saj në Britaninë e Madhe, nuk janë në kushte normale", 18 qershor 1962.

britanike ishte i kufizuar, derisa ajo vazhdonte të mos njihte vendimin e Gjykatës së Hagës dhe të shlyente dëmshpërblimin e caktuar prej saj.

Në vitin 1967 BBC-ja (British Broadcasting Company-Kompania Britanike e Transmetimeve) i ndërpreu transmetimet për Shqipërinë, të filluara që në vitin 1941, me një vendim qeveritar në fund të vitit 1966.¹⁴ Me gjithë përpjekjet e mëvonshme të Nicholas Bethell-it*, Julian Amery-t** dhe disa personaliteteve të tjera (me të shkuar të lidhur ngushtë me Shqipërinë), Foreign and Commonwealth Office (FCO***) – Zyra e Jashtme dhe e Komonuellthit e quajti pa interes rihapjen e programit të BBC-së për Shqipërinë.¹⁵ Ndonëse mbyllja e BBC-së argumentohej për shkaqe ekonomike, arsytet e vërteta kishin të bënin me faktin, se Shqipëria ‘kishte pak ose aspak rëndësi’ për politikën britanike, dhe se ‘nuk kishte treguar shenja hapjeje ndaj influencës së huaj’. Qeveria shqiptare vazhdoi t’i përmbahej politikës së njohur, të mospranimit të vendimit të Gjykatës së Hagës, i cili e bënte fajtores për incidentin e Kanalit të Korfuzit dhe rrjedhimisht edhe të detyrimeve që rridhnin prej saj. Deri në ndarjen e Shqipërisë me Kinën, të dyja palët u qëndruan pa kompromis kushteve të sipërpërmendura, pa ndryshuar ndonjë gjë esenciale në qëndrimet e tyre.

¹⁴ TNA, FCO 28/940, shih letrën e Julian Amery-t drejtuar Sekretarit të Shtetit më 27 nëntor 1970.

* *Nicholas William Bethell* - Politikan dhe historian britanik për Europën Qendrore dhe Lindore, anëtar i Dhomës së Lordëve nga viti 1967-1999. Autor i dy librave që lidhen me ngjarjet në Shqipëri: *The Great Betrayal: The untold story of Kim Philby's biggest coup* London (London: 1984) dhe *The Albanian operation of the CIA and MI6, 1949-1953: conversations with participants in venture Betrayed* (London: 2016).

** *Harold Julian Amery* - Anëtar i Parlamentit Britanik në vitet 1950-1992. Gjatë Luftës së Dytë Botërore shërbeu si oficer i Ndërlidhjes Britanike në Shqipëri së bashku me David Smiley-n dhe Neil McLean-in.

*** *Foreign and Commonwealth Office* (FCO), është një nga ministritë e Mbretërisë së Bashkuar, e cila u krijua në vitin 1968 nga bashkimi i Foreign Office (FO) dhe Commonwealth Office. Kjo ministri është përgjegjëse për mbrojtjen dhe promovimin e interesave britanikë në mbarë botën. FCO-ja drejtohet nga Sekretari i Shtetit për Punët e Jashtme të Commonwealth-it, që shkurt thirret - Sekretari i Shtetit. Posti i Sekretarit të Shtetit vlerësohet si një ndër katër emërimet më prestigjioze të Kabinetit Britanik.

https://en.wikipedia.org/wiki/Foreign_and_Commonwealth_Office (shikuar më 15.10.2016).

¹⁵ TNA, FCO 26/1200, 1972, 24 korrik 1972.

Përpjekje për të ‘ndrequr gardhin’ me Shqipërinë

Aty nga mesi i viteve '60 situata filloi të ndryshojë. Britanikët bënë përpjekje për të rregulluar marrëdhëniet me Shqipërinë (mending fences), e cila nga ana e vet ishte duke ‘arnuar’ marrëdhëniet politike e ekonomike me vendet fqinje dhe disa vende perëndimore. Përpjekjet e para jozyrtare u bënë nga shoqata e miqësisë Angli-Shqipëri dhe sekretari i saj, William Bland.¹⁶ Qeveritë e të dyja vendeve e konsideruan të tepruar iniciativën e ndërmarrë nga Bland-i, sepse çështja e rivendosjes së marrëdhënieve diplomatike, sipas tyre, ishte para së gjithash një problem për të dyja shtetet, zgjidhja e të cilit ishte pothuajse e pamundur që të arrihej nëpërmjet negocimit të një shoqate kulturore.¹⁷ Sidoqoftë, roli i shoqatës britaniko-shqiptare dhe i disa individëve me emër në jetën politike e publike angleze në vitet '60, nuk kaloi pa lënë gjurmë, por shërbeu si katalizator për të diskutuar, rreth një çështjeje të ngrirë e të mbingarkuar nga ngjarjet e mëparshme. Sekretari i Shtetit, në përgjigjen që i drejtonte deputetit britanik, Stan Newens - i interesuar për rivendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Shqipërinë, më 10 dhjetor 1965, përmendte arsyet kryesore të refuzimit, si mospërmbushja e vendimit të Gjykatës së Hagës; mungesa e interesit të qeverisë britanike; refuzimi i qeverisë greke, për shkak të frikës nga izolimi i mundshëm i saj; mungesa e propozimit zyrtar nga qeveria shqiptare, zgjedhja e kohës së papërshtatshme nga iniciatorët etj.¹⁸

Qeveria britanike edhe në këtë periudhë nuk hoqi dorë nga kërkesat e saj, që qeveria shqiptare të njihte dhe të pranonte juridiksionin e Gjykatës së Hagës, të shlyente dëmshpërblimin e caktuar prej saj, dhe pas

¹⁶ *Po aty*, FO 371/182535. Letër e parlamentarit, S. Newens për Sekretarin e Shtetit, “Marrëdhëniet diplomatike me Shqipërinë”, nëntor 1965; *William Bland* ka qenë aktivist politik dhe anëtar i Partisë Komuniste të Zelandës së Re, si dhe i Partisë Komuniste të Britanisë së Madhe. Një ndër krijuesit e shoqatës së miqësisë Angli-Shqipëri si dhe botues i revistës shoqërore “Albanian Life”. Së bashku me Ian Price-in shkroi librin: *A Tangled Web: A History of Anglo-American Relations with Albania (1912-1955)*.

¹⁷ *Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë* (më tej: *AQSH*), F. 14/AP, V. 1965, lista 22, D. 201, fl. 1-2. Letër e ministrit të Jashtëm të Shqipërisë Nesti Nase drejtuar Enver Hoxhës, Mehmet Shehut, Hysni Kapos dhe Ramiz Alisë, më 30 qershor 1965.

¹⁸ *TNA*, FO 371/182535. Përgjigje e Sekretarit të Shtetit për S. Newens-in, 10 dhjetor 1965.

tyre, të rivendoseshin marrëdhëniet diplomatike dhe t'i kthehej ari monetar Shqipërisë. Sekretari i Shtetit i bënte të ditur deputetit Frank Alloun, se “Shqipëria nuk ka paguar asnjë penny nga kompensimi i 800.000 £”.¹⁹

Qasja e re politike e qeverisë britanike ndaj Shqipërisë në fillim të viteve '70, është e lidhur me ngjarjet ndërkombëtare e lokale të ndodhura në atë periudhë, si: largimi zyrtar i Shqipërisë nga Traktati i Varshavës (shtator 1968) dhe ndryshimet e pjesshme të politikës së jashtme të saj; nga nisja e procesit të Detantës; nga nënshkrimi i marrëveshjeve dhe traktateve në gjysmën e parë të viteve '70, të cilat i qetësuan disi marrëdhëniet Lindje - Perëndim;²⁰ nga qasja e re politike e SHBA-së ndaj Shqipërisë, nga ndryshimet e ndodhura në politikën e jashtme të Kinës etj. Britanikët kryen fillimisht disa sondazhe, por u treguan të kujdesshëm, që të mos dukej se, po e merrnin ata të parët iniciativën për rivendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Shqipërinë. Me gjithë këto ndryshime, FCO-ja nuk hoqi dorë nga kushtet e saj të mëparshme për rivendosjen e marrëdhënieve diplomatike, si: kërkesat për dhënien e dëmshpërblimit të caktuar nga Gjykata e Hagës, zhvillimin e turizmit, shfrytëzimin e Shqipërisë për njohjen më të mirë të marrëdhënieve të Kinës me Bashkimin Sovjetik etj. Pas përmbushjes së tyre, do të shihej mundësia e rivendosjes së marrëdhënieve diplomatike, pa përjashtuar edhe diskutimin e njëkohshëm të këtyre çështjeve me kthimin e arit monetar të Shqipërisë.²¹

Në Londër kishte rrethe politike, të cilat e vlerësonin largimin e Shqipërisë nga TV-ja, por qëndronin në pritje të ndryshimeve të mëtejshme, e madje radikale në jetën politike e ushtarake të Shqipërisë. Mendohej se, nëse do të ruheshin ekuilibrat ekzistues dhe Shqipëria do të vazhdonte të qëndronte ndërmjet Lindjes dhe Perëndimit, politika britanike nuk do të kishte ndonjë motiv nxitës apo arsye madhore, që do ta detyronte, të ndryshonte qëndrimin e vet ndaj Shqipërisë dhe, ta shihte me përparësi problemin e rivendosjes së marrëdhënieve diplomatike.

¹⁹ *Po aty.*

²⁰ Henry Kissinger, *Diplomacia*, përktheu Petraq Pojani (Tiranë: Laert, 1999), 736-737; Lawrence Freedman, “The Confrontation of the Superpowers, 1945-1990”, in *The Oxford History of Twentieth Century*, edited by Michael Howard and W. Roger Louis (New York: Oxford University Press, 1988), 159.

²¹ TNA, FCO 28/613, 1968-1969. J.W. Hutson për T. Brimelow-n, tepër sekret, ‘Albania’, 26 gusht 1969.

Britania e Madhe nuk shihte ndonjë përfitim ekonomik nga një vend i vogël si Shqipëria.²² Disa diplomatë pragmatistë në FCO mendonin, se rivendosja e marrëdhënieve diplomatike me Shqipërinë do t'i shërbente më shumë strategjisë së vendeve perëndimore, për të mos lejuar që BS-ja të shfrytëzonte sërish territorin e saj për qëllime ushtarake, të dëmtohej stabiliteti i brendshëm i Jugosllavisë pas vdekjes së Titos, nga kundërveprimi i mundshëm i 1.3 milionë shqiptarëve të këtij vendi etj.²³ Përpjekjet për rivendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Shqipërinë u artikuluan edhe në shtypin britanik. Gazeta "Financial Times", duke sjellë në kujtesën e qytetarëve të vet *Rollback*-un, më 5 tetor 1972 shkruante, se "shqiptarët nuk i kanë harruar përpjekjet e Britanisë së Madhe në fund të viteve '40 dhe në fillim të viteve '50, për të përmbysur regjimin komunist në Shqipëri".²⁴

Qeveria britanike ndiqte me vëmendje prirjen e zhvillimeve amerikano-shqiptare dhe përpjekjet e Departamentit të Shtetit për të rivendosur marrëdhëniet diplomatike me Shqipërinë.²⁵ Përpjekjet e qeverisë britanike për të rivendosur marrëdhëniet diplomatike me qeverinë shqiptare u artikuluan qartazi në vitet 1972-1973, pothuajse në të njëjtën kohë me DSH-në. Sikurse në DSH, edhe në FO ushqeheshin shpresa se afrimi amerikano-kinez, do të reflektohej në politikën e jashtme të Shqipërisë dhe kjo e fundit do të ndiqte shembullin e Republikës Popullore të Kinës.

Sinjalin për vullnetin e Britanisë së Madhe për rivendosjen e marrëdhënieve me Shqipërinë e dha zëvendëssekretari i Jashtëm më 24 prill 1972, i cili deklaroi në Dhomën e Komuneve se "do të isha i lumtur nëse do të ishim në gjendje të gjenim rrugët për të kaluar vështirësitë, që kanë penguar rivendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Shqipërinë".²⁶ FCO-ja kontaktoi me Ministrinë e Punëve të Jashtme të Italisë, e cila pranoi rolin e ndërmjetësit. Britanikët mendonin se, nëse do të gjenin gatishmërinë e palës shqiptare, do të procedonin më tej me

²² *Po aty*, fl. 2-3.

²³ *Po aty*, FCO, 28/1741, R.D. Wilkins për T. Brimelow-n, 21 dhjetor 1971.

²⁴ *Po aty*, FCO, 28/1741, "Shqipëria lëviz drejt vendosjes së marrëdhënieve diplomatike me Britaninë", 5 tetor 1972.

²⁵ *Po aty*, FCO 28/1740, 1972. Pjesë nga raporti i DSH-së për politikën e jashtme me Shqipërinë për vitet 1969-1970 dhe 1971.

²⁶ *AMPJ*, V. 1973, D. 253. Informacion i Ksenofon Nushit, zëvendësministër i Punëve të Jashtme, 5 shkurt 1973.

fillimin e bisedimeve në Romë ose në New York.²⁷ Për të paraqitur propozimin britanikët përveç ambasadorit italian në Tiranë, shfrytëzuan edhe diplomatët turq e kinezë,²⁸ sikurse ishin aktivizuar edhe ambasadorët e Jugosllavisë e Rumanisë.²⁹ Nënsekretari britanik për Punët e Jashtme, Julian Amery, u kujdes personalisht për mbarëvajtjen e procesit. Më 24 prill 1972 në Parlamentin Britanik u ngrit për herë të parë çështja se, si do të konsiderohej procesi i marrëdhënieve diplomatike me Shqipërinë rivendosje apo vendosje e tyre.³⁰

Në këtë klimë pozitive u riaktivizuan deputetët e Parlamentit Britanik, si Frank Allaun, Stan Newens etj., të cilët në vitin 1976 i shpeshatuan përpjekjet për rivendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Shqipërinë. Në Dhomën e Komuneve u kërkua sërish që të dihej, nëse Qeveria e Madhërisë së Tij e kishte njohur qeverinë e Shqipërisë në vitin 1945-46, dhe nëse përgjigjja do të ishte pohuese, si do të konsideroheshin marrëdhëniet diplomatike me Shqipërinë, të ndërprera, apo të pezulluara? Departamenti i Kërkimit, i atashuar pranë Sektorit të Europës Lindore dhe Bashkimit Sovjetik në FCO, pasi shqyrtoi dokumentacionin e viteve 1945-1946, iu përgjigj në mënyrë pohuese këtyre pyetjeve.³¹ U gjykua se, Qeveria e Madhërisë së Tij (*His Majesty's Government* – HMG) e kishte njohur qeverinë shqiptare në nëntor të vitit 1945, por për arsye të vështirësive të krijuara nga kjo e fundit, si rezultat i incidenteve të Kanalit të Korfuzit, nuk ishte proceduar më tej me shkëmbimin e misionëve diplomatike. Këshilltarja ligjore, Wilmshurst, pohonte se nuk ishte e saktë të flitej për ndërprerjen e marrëdhënieve diplomatike të Qeverisë së Madhërisë së Tij me Shqipërinë në vitin 1946, por për pezullim të rivendosjes së tyre.³²

²⁷ *Po aty*, fl. 3, 5. Informacion i Ksenofon Nushit, 3 shkurt dhe 11 maj 1973; NARA, RG 59, Box. 2036, POL ALB-UK. Memorandum bisede, ‘qasja britanike për Shqipërinë’, 17 korrik 1973.

²⁸ *AMPJ*, V. 1973, D. 253, fl. 12-13. Informacion i ministrit të Punëve të Brendshme Kadri Hazbiu, nr. 4315, 31 gusht 1973.

²⁹ *TNA*, FCO 28/1741. Bullard-i për T. Brimelow-n, “Marrëdhëniet me Shqipërinë”, 14 dhjetor 1972.

³⁰ *Po aty*.

³¹ *Po aty*, FCO 28/2842, V. 1976, fl. 8, 10. M.F. Sullivan për Michael Leyland Nash-in – Norwich City College, 21 maj 1976; M.F. Sullivan për Michael Leyland Nash-in, 15 qershor 1976.

³² *Po aty*, FCO 28/3005, V. 1977. Letër e P. Rennie-së, East European Section Research Department për Miss Brown (EESD), 13 janar 1977; letër e E. S. Wilmshurst për P.

Udhëheqja komuniste e Shqipërisë dhe qeveria e saj nuk iu përgjigjën direkt ftesës së HMG-së për rivendosjen e marrëdhënieve diplomatike. Por gazeta kryesore, “Zëri i Popullit”, organ zyrtar i KQ të PPSH-së, shkruante se, Shqipëria nuk e mbështet ‘tullumbacen e provës’ të lëshuar nga imperialistët e vjetër e të rinj, të cilët janë në kërkim të rrugëve për të hyrë në Shqipëri.³³ Me këtë përgjigje, refuzoheshin jo vetëm propozimet e SHBA-së e Britanisë së Madhe, por ca më shumë kërkesa e përsëritur e Bashkimit Sovjetik për rivendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Shqipërinë. Në fjalimin elektorale të 3 tetorit 1974, Enver Hoxha e bëri të qartë se, nuk mund të vendoseshin marrëdhëniet diplomatike me Britaninë e Madhe, pa i kthyer më parë Shqipërisë të gjithë arin e “vjedhur”, së bashku me interesat.³⁴ Qeveria shqiptare nuk e refuzoi prerazi propozimin e qeverisë britanike, sikurse kishte bërë me atë të DSH-së, por as nuk pranoi të fillonte bisedimet, pa zgjidhur më parë problemin e arit monetar shqiptar.

Qeveria britanike në vitin 1977, ndiqte me vëmendje të veçantë kursin negativ të marrëdhënieve shqiptaro-kineze, ndarjen e pritshme të të dyja vendeve dhe pasojat e saj mbi Shqipërinë. Këtij qëllimi i shërbeu përgatitja e disa studimeve dhe analizave nga ekspertë të njohur brenda apo jashtë FCO-së. Për shkak të vlerave që paraqet, do të përqendrohemi te studimi i përgatitur më 5 gusht 1977 nga J. H. Figgis - kërkues në Departamentin e Europës Lindore dhe Bashkimin Sovjetik pranë FCO-së.³⁵ Megjithëse ndarja shqiptaro-kineze ishte shfaqur në horizont, shenjat për ndryshime në Shqipëri nuk dukeshin dhe aq premtuese, duke

Rennie-n, “Marrëdhëniet diplomatike anglo-shqiptare”, 21 dhjetor 1976. Këshilltarja legale E. S. Wilmshurst i dha përgjigje pyetjes, se a mund të konsideroheshin të vendosura marrëdhëniet diplomatike me Shqipërinë, pa dërguar misionin në këtë vend? Bazuar në artikullin 2 të Konventës së Vjenës (1961) mbi marrëdhëniet diplomatike, dhe në Komisionin Ndërkombëtar të Ligjeve (ILC 1957) sqaroi se, institucioni i marrëdhënieve diplomatike dhe vendosja e misionit diplomatik janë dy gjëra të ndryshme. Si shembull u përdor rasti i marrëdhënieve të Britanisë së Madhe me Vatikanin. Britania kishte akredituar në shtetin e Vatikanit trupin e vet diplomatik, ndërsa ky i fundit, nuk kishte dërguar misionin e tij në Londër, por marrëdhëniet diplomatike ekzistonin.

³³ *Po aty*, FCO 28/1741, 1972. Bullard-i për T. Brimelow-n, “Marrëdhëniet me Shqipërinë”, 14 dhjetor 1972.

³⁴ *Zëri i Popullit*, Tiranë, 04.10.1974.

³⁵ TNA, FCO 21/560, Viti 1977. Studim i përgatitur nga J. H. Figgis në Eastern European and Soviet Department drejtuar M. N. Fen-it në British Embassy Peking, “Perspektiva për ndryshime në marrëdhëniet e jashtme të Shqipërisë”, 5 gusht 1977.

grykuar mbi personalitetin e Enver Hoxhës dhe rolin e tij vendimtar mbi zhvillimin e vendit. Hoxha konsiderohej në këtë studim, si “i burgosur fanatik i ideologjisë së vet, si person paranojak, i vendosur për të garantuar dhe mbrojtur regjimin e tij”. Ai, grykohej si një udhëheqës, që nuk ishte në gjendje të ndiqte evolucionin e politikës së jashtme të Mao Ce Dunit, por si një drejtues që kishte hyrë në një garë [me kinezët], për të siguruar udhëheqjen e lëvizjes marksiste-leniniste në botë.³⁶

Në studim hidhej ideja se ndarja e Shqipërisë me Kinën ishte fenomen i pritshëm, i cili do të shoqërohej me ndryshime në politikën e jashtme të Shqipërisë. Analisti gjakftohtë britanik grykonte se, opsioni më i mundshëm për të ardhmen e vendit, do të ishte ndjekja e politikës së vetizolimit dhe e mbështetjes në forcat e veta. Por, nuk përjashtoheshin as alternativat e tjera, si rikthimi i Shqipërisë në orbitën e Bashkimit Sovjetik, riafrimi i saj me Kinën, apo hapja e ngadaltë ndaj Perëndimit. Në studim arrihej në konkluzionin se, Shqipërisë së mbetur vetëm dhe pa mbështetje ekonomike e ushtarake, do t’i shteronin rezervat dhe herët apo vonë do të detyrohej të lëvizte ngadalë drejt Europës Perëndimore dhe tregtisë botërore.³⁷

Duke pasur në konsideratë trashëgiminë negative dhe barrierat ideologjike e ligjore të shtetit shqiptar, parashikohej që lëvizja e Shqipërisë drejt Perëndimit do të ecte në tri shina kryesore, të cilat do të përfshinin tregtinë e jashtme, forcimin e lidhjeve të Shqipërisë me vendet fqinje ballkanike (Greqinë, Jugosllavinë, Italinë), afrimin e saj gradual me Britaninë e Madhe dhe Republikën Federale Gjermane (RFGJ), pjesëmarrjen në Konferencën për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë (KSBE) etj.* Nëse do të ndodhnin ndryshimet e parashikuara, qeveria angleze do të duhej që t’i jepte një sinjal të qartë Shqipërisë, për dëshirën dhe vullnetin e saj për të normalizuar marrëdhëniet dypalëshe. Si hap i parë, do të shërbente dërgimi në Shqipëri i një misioni, i cili do të testonte prirjet e politikës shqiptare dhe përpjekjet e saj për zhvillimin e dyanshëm të tregtisë. Duke qenë të vetëdijshëm për kërkesën permanente të qeverisë shqiptare në lidhje me kthimin e arit të saj monetar, në FCO mendohej se mund të ofronin një zgjidhje më elastike, duke

³⁶ *Po aty*, FCO 21/560, Viti 1977.

³⁷ *Po aty*.

* Dy parashikimet e para u vërtetuan, ndërsa pjesëmarrja e Shqipërisë në KSBE mbeti një “mollë e ndaluar” deri në maj të vitit 1990, kur Shqipëria u pranua me statusin e vëzhguesit dhe një vit më vonë, si vend anëtar me të drejta të plota.

bashkëpunuar me SHBA-në dhe Francën, si vende anëtare të Komisionit Trepalësh.

Shpresa në rritje pas ndarjes me Kinën

Ndarja shqiptaro-kineze e vitit 1978 e futi Shqipërinë në rrugën e vetizolimit dhe të vështirësive të mëdha ekonomike. Mbetja e saj për herë të parë, që nga mbarimi i Luftës së Dytë Botërore (por edhe më herët) pa një vend të madh aleat u prit me shqetësim në Perëndim. Dyshimi dhe shqetësimi kryesor i tyre lidhej me afrimin e mundshëm të Shqipërisë me Bashkimin Sovjetik, me rikthimin e saj në Bllokun e vendeve komuniste dhe në Traktatin e Varshavës. Një opsion i tillë do ta vendoste Perëndimin në pozita të pafavorshme, sepse do të prishte ekuilibrat e krijuar në Europë dhe do të dëmtonte krahun juglindor të NATO-s, duke e bërë më të brishtë mbrojtjen e Greqisë dhe të Italisë.³⁸ E rrezikuar do të ishte pavarësia e Shqipërisë, por edhe e fqinjës së saj, Jugosllavisë.

Rivendosja e marrëdhënieve diplomatike me Shqipërinë, në FCO gjykohej para së gjithash, si kontribut i Britanisë së Madhe për interesat perëndimorë. Arritja e saj shihej si një qëllim politik afatgjatë, por i mundshëm, në kushtet kur Shqipëria kishte shfaqur interes për iniciativën britanike. Vendet perëndimore dhe veçanërisht Britania e Madhe dhe SHBA-ja e shihnin afrimin me Shqipërinë, si mundësi për ta mbajtur këtë të fundit, jashtë sferës së influencës së Bashkimit Sovjetik. “Ekzistonte një interes i rëndësishëm i Perëndimit në Shqipëri, duke patur në konsideratë rëndësinë strategjike të saj, për të bërë çdo gjë, që ta mbajë atë jashtë sferës së influencës sovjetike”.³⁹ Nëse Shqipëria rikthehej në gjirin e Bllokut Komunist, veçanërisht e rrezikuar do të ishte Jugosllavia e cila nuk ishte anëtare e NATO-s. Jugosllavia mund të bëhej objekt i një sulmi të vendeve të Traktatit të Varshavës, por edhe i destabilizimit të jashtëm apo të brendshëm pas vdekjes së Titos. Në prill të vitit 1980, ndihmëssekretari amerikan i Shtetit, Robert Barry bëri një deklaratë të fortë kundër përpjekjeve të mundshme të Bashkimit Sovjetik dhe aleatëve të tij, por edhe kundër përpjekjeve të grupeve të emigracionit jugosllav në SHBA apo jashtë saj, të cilët mund të favorizonin trazira dhe prishjen e

³⁸ *AMPJ*, V. 1979, D. 730, fl. 6. Relacion i Abdi Baletës nga New York-u për MPJ-në, 2 gusht 1979.

³⁹ *TNA*, FCO 28/3705, f. 17. K.B.A. Scott për J. Kelley-n (His Majesty's Treasury), Whitehall, 28 mars 1979.

Jugosllavisë. “Jugosllavia,- deklaronte ai, - mund të shihet me besim si një shtet i zhvilluar e i pavarur, plotësisht i zoti që të menaxhojë çështjet e brendshme dhe të mbrojë veten kundër agresionit të jashtëm. Ne, do të bëjmë çfarë të mundemi që të kontribuojmë për këtë qëllim”.⁴⁰

Në FCO (Departamenti i Europës Lindore dhe Bashkimit Sovjetik) u kryen disa studime dhe u bënë prognoza për të ardhmen e marrëdhënieve britaniko-shqiptare, duke paraparë mundësitë për kapërcimin e pengesave të njohura. Politika e Britanisë së Madhe ndaj Shqipërisë në vitin 1979, analizohet me shumë kujdes në broshurën me titull “Studim i Britanisë së Madhe mbi marrëdhëniet me jashtë të Shqipërisë”.⁴¹ Studimi në thelb ndryshonte pak nga ai i vitit 1977. Ndarja e Shqipërisë me Kinën, sikurse ishte parashikuar kishte ndodhur, ndërsa rebuset se nga do të shkonte Shqipëria, me Perëndimin apo me Lindjen nuk ishin davaritur ende. Vazhdohej të besohej se alternativa kryesore për zhvillimin e vendit do të ishte zbatimi i parimit të mbështetjes në forcat e veta. Hapja e vendit me Perëndimin shihej si një proces gradual, që do të kërkonte kohë. Sidoqoftë, pengesat për të rivendosur marrëdhëniet me Britaninë e Madhe, dukeshin më të kapërcyeshme, sesa “rruga” që do të përshkohej për të rivendosur marrëdhëniet diplomatike me SHBA-në dhe Bashkimin Sovjetik.

Karakteristikë e viteve '70 dhe '80 ishte se, qeveria britanike e shtoi interesin për rivendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Shqipërinë, duke e shoqëruar me aksione diplomatike, por përgjigjja e qeverisë shqiptare ishte joproporcionale. Britanikët hoqën dorë nga politika e mëparshme e drujtjes dhe e sondazheve, duke bërë hapa konkretë për afrimin zyrtar ndërmjet të dyja vendeve. Gjatë kësaj periudhe, diplomatët britanikë i shtuan komunikimet dhe konsultimet me homologët e tyre amerikanë, francezë, italianë, austriakë etj. Në veçanti u kërkuar ndihma e Francës e cila konsiderohej, me të drejtë, si vendi perëndimor më afër Shqipërisë. Në diskutime u përfshi Parlamenti Britanik, Ministria e Jashtme, ambasadorë e diplomatë të këtij vendi, të akredituar në vende të ndryshme të botës, shoqatat e miqësisë, shtypi dhe disa persona të veçantë me ndikim publik e politik. Deputetë të

⁴⁰ *Po aty*, FCO 28/4071, V. 1980. Judith Brown për J.C.R. Gay-n, 30 prill 1980.

⁴¹ *Po aty*, FCO 28/3705. “Studim i Mbretërisë së Bashkuar mbi marrëdhëniet me jashtë të Shqipërisë”, R. F. Cooper drejtuar FCO-së, 1 qershor 1979, 29 faqe; “Ndryshimet e fundit në marrëdhëniet me jashtë të Shqipërisë, implikime në politikën britanike”, 1 shkurt 1979, përgatitur nga Reginald Hibbert.

Parlamentit Britanik, si David Atkinson, J. Biggs, Frank Dobson, Nicholas Rodley, Laurich Pavitt, Richard Luce, Ivor Slanbrook, Geoffrey Stewart-Smith kërkuan sqarime për këtë çështje. Ministri i Shtetit, Peter Blaker, më 13 shkurt 1980 kishte bërë të ditur në Dhomën e Komuneve se, “qeveria britanike e kishte bërë të qartë gatishmërinë e saj, për të gjetur rrugët për të kapërcyer pengesat për rivendosjen e marrëdhënieve diplomatike. Pala jonë, - shprehej ai më tej, - do të pëlqente ndarjen e këtyre çështjeve (financiare) nga rivendosja e marrëdhënieve diplomatike. Por për fat të keq, Shqipëria deri tani ka këmbëngulur dhe nuk është e gatshme për rivendosjen e marrëdhënieve diplomatike, derisa t’i kthehet ari”.⁴²

Rivendosjen e marrëdhënieve diplomatike e mbështeti shoqata e miqësisë Britani-Shqipëri e krijuar në vitet ’60, si dhe shoqata tjetër e krijuar pas ndarjes së Shqipërisë me Kinën e cila drejtohej nga Dayrell R. Oakley-Hill*. Shumë aktiv u tregua edhe profesori dhe diplomati anglez, Michael F. Smith.** Në shtypin vendës u botuan disa artikuj për problemin e rivendosjes së marrëdhënieve diplomatike.⁴³ Disa ambasadorë dhe diplomatë të tjerë britanikë kontaktuan me diplomatë shqiptarë dhe bënë të qartë seriozitetin e propozimeve të tyre dhe nevojën e rivendosjes së marrëdhënieve diplomatike.⁴⁴ Të gjithë dëshironin dhe kishin si synim përmirësimin e marrëdhënieve me Shqipërinë. Në këtë periudhë u ringrit si asnjëherë tjetër kërkesa për të hapur bisedimet me Shqipërinë, ndonëse rruga për rivendosjen e marrëdhënieve diplomatike parashikohej e gjatë dhe me pengesa. Të tjerë persona publikë si Martin Moir,*** kontaktuan me parlamentarë, me diplomatë dhe veçanërisht me

⁴² AMPJ, V. 1980, D. 1158/2, fl. 89. Letër e ministrit të Shtetit Peter Blaker (anëtar i Parlamentit Britanik) për deputetin Ivor Stanbrook, 25 shkurt 1980.

* *Oakley Hill* gjatë periudhës së Mbretit Zog shërbeu në Shqipëri si oficer britanik që trajnonte xhandarmërinë shqiptare. Në vitet 1945-1946 drejtoi Misionin e UNRRA-s në Shqipëri. Zëvendës i Hill-it ishte Dervish Duma.

** *Michael Smith* - Profesor në Universitetin e Wells-it të Veriut dhe diplomat në Departamentin e Europës Lindore dhe Bashkimit Sovjetik.

⁴³ *The Times*, London, 7, 11.11.1978.

⁴⁴ AMPJ, V. 1979, D. 327. Shih kontaktet e ambasadorit Sokrat Plaka në Beograd me ambasadorin britanik; takimin e ambasadorit britanik në Paris, Reginald Hibbert me Misto Treskën në korrik të vitit 1979; letrën e M.J.G. Moir-it drejtuar Enver Hoxhës, më 6 qershor 1979; Përpjekjet e profesorit dhe diplomatit Michael F. Smith etj.

*** *Martin Moir* ishte person publik që bëri shumë përpjekje për rivendosjen e marrëdhënieve diplomatike të Anglisë me Shqipërinë në fund të viteve ’70 dhe në vitet

Sekretarin e Shtetit, për të nxitur e për të zgjidhur këtë problem të ngrirë për disa dhjetëra vjet.

Diplomatët britanikë kontaktuan për këtë qëllim, në mënyrë të veçantë me homologët e tyre amerikanë, të interesuar për rivendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Shqipërinë, por edhe me ata italianë e francezë, të cilët kishin misionet e tyre diplomatike në Shqipëri. Britania e Madhe ishte e gatshme që të rikthente një pjesë apo të gjithë sasinë e arit monetar, që i ishte bllokuar Shqipërisë, në këmbim të zgjidhjes së problemeve dypalëshe dhe të rivendosjes së marrëdhënieve diplomatike. Britania e Madhe, përveç pagesës së dëmshpërblimit të njohur, nuk kishte ndonjë pretendim tjetër financiar ndaj Shqipërisë.⁴⁵ Qeveria angleze kishte dëmshpërblyer nga burimet e veta familjet e të vrarëve dhe të dëmtuarve nga incidenti i Kanalit të Korfuzit. Marrja e dëmshpërblimeve nga Shqipëria ishte për të, një çështje parimore, ligjore e morale. Në planin tregtar Shqipëria nuk paraqiste interes për Anglinë. Marrëdhëniet e saj tregtare me Shqipërinë në vitin 1979 kishin një peshë shumë të vogël. Anglia kishte eksportuar në Shqipëri mallra me vlerë 700 000£ dhe kishte importuar prej saj vetëm 62 000 £.⁴⁶

Udhëheqësit komunistë të Shqipërisë u treguan të rezervuar për t'u afruar me Anglinë, ndonëse vendi po përballej me vështirësi serioze ekonomike, politike e sociale. Vazhdonin të ishin në fuqi disa klauzola penguese, të sanksionuara në Kushtetutën e vitit 1976, që e ndalonin marrjen e ndihmave dhe të kredive nga jashtë. Edhe gjatë kësaj periudhe ajo nuk kishte hequr dorë nga kërkesa për kthimin paraprak të arit monetar, si kusht për rivendosjen e marrëdhënieve diplomatike. Mehmet Shehu më 28 nëntor 1979, deklaronte: “Për sa u përket marrëdhënieve diplomatike me Britaninë e Madhe dhe RFGJ, ato mund të diskutohen

⁴⁵ Ai u shkroi disa deputetëve të Parlamentit Britanik, Sekretarit të Jashtëm dhe personave të tjerë me influencë në Angli. Moir-i mendonte se vendimi i Gjykatës së Hagës ndaj Shqipërisë ishte i padrejtë dhe duhej rihapur. Fajtores sipas tij ishte Jugosllavia, e cila duhej të përballej me drejtësinë. Ka ardhur disa herë në Shqipëri dhe i ka shkruar personalisht Enver Hoxhës, Ramiz Alisë, madje edhe Josip Broz Titos. Letërkëmbimin e tij ia ka dorëzuar Arkivit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë. Përpijekjet e tij nuk u vlerësuan si duhet nga institucionet zyrtare të Shqipërisë komuniste, sepse dyshohej si person që donte të fitonte besimin e regjimit, për ta përdoruar atë më tej për qëllime sekrete.

⁴⁵ TNA, FCO 28/3705, f. 17/3. K.B.A. Scott për J. Kelley-n – HM Treasury, Whitehall, 28 mars 1979.

⁴⁶ AMPJ, V. 1980, D. 1158/2, fl. 96. I.A.C. Bruce për M.J.G. Moir-in, 27 shkurt 1980.

kur këto vende të shlyejnë detyrimet ndaj Shqipërisë”.⁴⁷ Reiz Malile (zëvendësministër i Jashtëm) nëpërmjet një radiogrami që i drejtonte ambasadës shqiptare në Pragë, në janar të vitit 1979, theksonte: “Kini parasysh se ne nuk i vëmë në një plan SHBA-në dhe Anglinë. Me të parën nuk mbajmë asnjë lidhje dhe nuk bisedojmë me diplomatët amerikanë, ndërsa me Anglinë kemi probleme të diskutueshme, për të cilat është folur në fjalimet e fundit të shokut Enver dhe shokut Mehmet. Me diplomatët anglezë kur afrohen për të biseduar mbani qëndrim dinjitoz dhe i dëgjoni çfarë kanë për të thënë. Ju të tregoheni të matur dhe të kujdesshëm në bisedat eventuale me ta dhe bisedat të jenë të shkurtra”.⁴⁸ Në gazetën “Zëri i Popullit” botoheshin jo rrallë artikuj për interesimin e shfaqur nga disa vende perëndimore, apo nga Bashkimi Sovjetik, për rivendosjen, apo vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Shqipërinë. Por, ndërsa përgjigjet e udhëheqjes komuniste ndaj kërkesave apo sondazheve diplomatike të SHBA-së dhe BS-së ishin të prera e refuzuese, ndaj Britanisë së Madhe dhe Republikës Federale Gjermane dera mbahej gjysmë e hapur. Për qeverinë shqiptare dy ishin çështjet në të cilat ishte e bindur se nuk do të “lëshonte pe”: kërkesat për kthimin e arit nga Britania e Madhe dhe likuidimin e dëmshpërblimeve të mbetura nga Lufta e Dytë Botërore nga RFGJ-ja.

Pas një pauze të gjatë (që nga viti 1961), më 6 shkurt 1979, qeveria shqiptare iu drejtua zyrtarisht Komisionit Trepalësh për kthimin e arit së bashku me interesat.⁴⁹ Duke pasur në konsideratë marrëdhëniet relativisht të mira të Francës me Shqipërinë, pozitën asnjëanëse të saj në këtë çështje, si dhe qenien e saj si vend anëtar i Komisionit Trepalësh për kthimin e arit monetar, qeveria shqiptare iu drejtua veçmas asaj, duke i kërkuar që të ushtronte ndikimin e vet në zgjidhjen e këtij problemi. Por, pas konsultimeve me qeverinë britanike, në tetor të vitit 1980, qeveria franceze i bëri të ditur qeverisë shqiptare, se marrja e vendimit nuk ishte atribut i saj, por i tri qeverive anëtare të Komisionit Trepalësh. Të njëjtën përgjigje mori qeveria shqiptare edhe nga Komisioni Trepalësh, i cili i bëri të qartë se, “çdo vendim për dorëzimin e arit varet nga qeveritë e

⁴⁷ TNA, FCO 28/3706, 7 dhjetor 1979; AMPJ, V. 1979, D. 327, shih: “Shqipëria është e vendosur të mos kërkojë kredi”, në *Zëri i Popullit*, Tiranë, 28.11.1979.

⁴⁸ AMPJ, V. 1979, D. 327, fl. 3. Radiogram nr. 182, 15 janar 1979.

⁴⁹ *Po aty*, V. 1979, D. 1228/10, fl. 9. Notë e Ministrisë së Jashtme drejtuar Komisionit Trepalësh për kthimin e arit monetar, nr. 368, 6 shkurt 1979.

SHBA, Britanisë së Madhe dhe Francës”.⁵⁰ Përfaqësuesi britanik në Komisionin Trepalësh, Wenban Smith, gjatë bisedës me ambasadorin e Shqipërisë në Francë, Dhimitër Lamani, krahas të tjerave, theksoi se për ‘dorëzimin fizik’ të arit, Shqipëria duhej që të hynte në bisedime me Britaninë e Madhe, duke lënë të nënkuptohej se më parë duhej që të vendoseshin marrëdhëniet diplomatike, ndërsa diplomati shqiptar i konsideronte të ndara këto dy çështje.⁵¹ Në të njëjtën linjë mendimi ishte edhe ambasadori britanik në Beograd, i cili më 18 shkurt 1982, deklaronte se, kthimi i arit nuk ishte nën kompetencën e qeverisë britanike, por të Komisionit Trepalësh. Për herë të parë ai përmendi zyrtarisht edhe pretendimet financiare të SHBA-së ndaj Shqipërisë, të cilat buronin nga shtetëzimet e pronave të shqiptaro-amerikanëve nga pushteti komunist në vitet ’40.⁵² Në fillim të viteve ’80 Komisioni Trepalësh kishte zgjidhur mosmarrëveshjet për arin me Çekosllovinë dhe me Poloninë, por jo me Shqipërinë.⁵³

Në vitin 1980, pas një qëndrimi të ngurtë gati 30-vjeçar, qeveria angleze bëri një hap përpara për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, duke e ndarë çështjen e vendosjes së marrëdhënieve diplomatike nga zgjidhja e pretendimeve të dyanshme financiare. Zgjidhja e pretendimeve financiare, premtohej se do të arrihej, pas vendosjes së marrëdhënieve diplomatike, në kushte më të mira afrimi e mirëbesimi. “Ne, - theksonte ministri anglez i shtetit, z. Peter Blaker, - i propozuam Shqipërisë së fundi, që marrëdhëniet diplomatike të vendosen pa pritur zgjidhjen e çështjeve financiare, të cilat deri tani janë bërë pengesë”.⁵⁴ Propozimi i

⁵⁰ *Po aty*, V. 1979, D. 327, fl. 3, 20. Radiogram nr. 182, 15 janar 1979; *po aty*, V. 1991, D. 58, fl. 6. “Mbi problemet me Anglinë dhe problemi i arit monetar”, 23 tetor 1991. Vlera e arit monetar shqiptar në këtë kohë vlerësohej në 16 milionë \$.

⁵¹ *Po aty*, V. 1979, D. 1228/10, fl. 22.

⁵² *Po aty*, V. 1982, D. 454, fl. 18. Raport i Idriz Bardhit drejtuar MPJ-së, 26 gusht 1982.

⁵³ *Po aty*, V. 1982, D. 1214, fl. 1. Agjencia Telegrafike Shqiptare më 29 janar 1982 njoftonte se, Çekosllovakia, SHBA-ja dhe Britania e Madhe kishin arritur marrëveshjen për t’i kthyer shtetit çekosllovak 18,5 ton ar, të grabitur nga gjermanët gjatë Luftës së Dytë Botërore. Mbi gjysma e arit me vlerë 131.5 milionë \$ i kaloi SHBA-së dhe Britanisë së Madhe.

⁵⁴ *Po aty*, V. 1980, D. 1158/2, fl. 179. John Biggs për Martin Moir-in, deklaratë e ministrit të Shtetit Peter Blaker, nr. 119W, 19 maj 1980.

Shënim. Martin Moir i dorëzoi Arkivit Qendror të Shtetit letërkëmbimin e tij personal me institucionet dhe personalitete shtetërore e publike, në mbështetje të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve shqiptaro-britanike dhe rivendosjes së marrëdhënieve diplomatike.

qeverisë britanike shënonte progres, apo siç quhej prej saj ‘lëshim historik’, duke ditur se që nga viti 1951 ajo i ishte përmbajtur formulës së njohur, ‘se pa kthyer dëmshtëpërblimin’ nuk mund të rivendoseshin marrëdhëniet diplomatike me Shqipërinë. Ambasadori britanik në Beograd, Robert Farquharson i bënte të ditur ambasadorit shqiptar Sokrat Plakës, se “qeveria e tij nuk vendos marrëdhënie diplomatike, kur ka probleme të tilla të pazgjidhura”.⁵⁵

Propozimi i ri i britanikëve në vitin 1980, ishte në fakt një mundësi e mirë për kompromis. Por ai ndeshi në refuzimin e qeverisë shqiptare dhe në mungesën e elasticitetit të saj, ndonëse ndonjë diplomat si Sokrat Plaka propozuan zgjidhjen e njëhershme të problemeve financiare me vendosjen e marrëdhënieve diplomatike. Qeveria shqiptare vazhdoi t’i përmbahej formulës së vjetër, se, së pari, duhej që t’i kthehej ari monetar së bashku me interesat dhe, më pas të vendoseshin marrëdhëniet diplomatike.⁵⁶ Pala britanike vazhdoi të mbetej e hapur ndaj ofertës së lartpërmendur edhe pas refuzimit të qeverisë shqiptare. Problemi i rivendosjes së marrëdhënieve diplomatike me Shqipërinë, si asnjëherë tjetër u shndërrua në temë të diskutueshme e të debatueshme në mjediset zyrtare e publike. Ambasadorë dhe diplomatë të ndryshëm britanikë e paraqitën dhe e shpjeguan propozimin e qeverisë së tyre për të rivendosur marrëdhëniet diplomatike me Shqipërinë kudo ku ndodheshin. Por diplomatët shqiptarë e refuzuan, duke zbatuar pa mëdyshje udhëzimet dhe urdhrat e dhëna nga qeveria shqiptare. Në dhjetor të vitit 1980, dy shoqatave ekzistuese në Britaninë e Madhe iu shtua edhe një e tretë, objektivi kryesor i së cilës ishte rivendosja e marrëdhënieve me Shqipërinë. Shoqata drejtohej nga profesori i Uellsit Verior, Martin Smith, ndërsa në përbërjen e saj kishte persona me reputacion publik e politik, duke përfshirë edhe një numër të konsiderueshëm deputetësh - anëtarë të Parlamentit Britanik. Gjatë veprimtarisë së saj në favor të rivendosjes së marrëdhënieve diplomatike me Shqipërinë, u kryen interpelanca, u zhvilluan diskutime e debate në këtë institucion ligjvënës,

⁵⁵ AMPJ, V. 1980, D. 388, fl. 8. Informacion i Sokrat Plakës drejtuar MPJ-së (personalisht Enver Hoxhës e Mehmet Shehut), nr. 696, 25 shkurt 1980.

⁵⁶ Enver Hoxha, *Raport mbi veprimtarinë e Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, mbajtur në Kongresin e 8-të të PPSH-së*, 1 nëntor 1981 (Tiranë: 8 Nëntori, 1981), 208; AMPJ, V. 1980, D. 1158/1. Më 3 janar 1980, sipas llogaritjes së Bankës së Shtetit Shqiptar, vlera e arit monetar shqiptar sipas tregut të Londrës ishte 22 786 698 \$.

u thirr për të dhënë sqarime edhe Sekretari i Shtetit, madje u vu në lëvizje edhe Kryeministrja, Margaret Thatcher.

Vendosja e marrëdhënieve diplomatike të Britanisë së Madhe dhe Republikës Federale Gjermane me Shqipërinë, doli jashtë kuadrit të interesave bilateralë. Të interesuara për mbarëvajtjen e këtij procesi ishin edhe vendet e Tregut të Përbashkët Europian (TPE), të cilat dëshironin që të zgjidheshin problemet e mbartura nga e kaluara, në mënyrë që t'i shërbej më mirë paqes dhe uljes së tensioneve në kontinentin e vjetër. Për të zgjidhur ngërçin e Shqipërisë me këto dy vende dhe për të zbutur 'krenarinë shqiptare' u propozuan ndërmjetësime nga shtete të treta, si Finlanda, Suedia, Zvicra, Austria e madje edhe Greqia. Por, qeveria shqiptare iu përmbajt zgjidhjeve mbi baza bilaterale. Deri në fillim të vitit 1985 procesi i rivendosjes së marrëdhënieve me Britaninë e Madhe nuk kishte shënuar progres. Ministri i Jashtëm i Shqipërisë, Reiz Malile, më 29 mars 1985 i shkruante ministrit të Brendshëm Hekuran Isai, për nevojën e botimit të një artikulli 'të fortë' në gazetën "Zëri i Popullit", për të demaskuar imperializmin amerikan, si armik i betuar i popullit shqiptar dhe i popujve të botës. Kjo, sipas tij, "do t'i jepte një goditje zhurmës se Shqipëria po 'hapet me kujdes' drejt Perëndimit dhe do të tregonte se vendi ynë ndjek me konsekuencë politikën krejtësisht të pavarur të përcaktuar nga Partia".⁵⁷

Negociata të pasuksesshme

Në rrethanat kur propozimet e BS-së për rivendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Shqipërinë nuk mungonin, kur vdekja e pritshme e Enver Hoxhës mund të shoqërohej me ndryshime, që mund të çonin në rikthimin e Shqipërisë në sferën sovjetike, me iniciativën e Britanisë së Madhe dhe me pëlqimin e Shqipërisë, Franca mori përsipër rolin e ndërmjetësit. Më 20 prill 1984, ambasadori francez në Tiranë, Marcel Marten i paraqiti Ministrisë së Jashtëme të Shqipërisë, "propozimin prej 7 pikash".⁵⁸ Propozimi në thelb, përmbante kushtet për zgjidhjen tërësore dhe të njëkohshme të pretendimeve financiare të të

⁵⁷ AMPJ, V. 1985, D. 872, fl. 44. Letër e Reiz Maliles për Hekuran Isain, nr. 1164/1, 29 mars 1985.

⁵⁸ Po aty, V. 1991, D. 58, fl. 6; po aty, V. 1987, D. 1169, fl. 5-7; K. Krisafi, *Në kërkim të arit*, 177-188.

dyja palëve, të cilat do të sillnin rivendosjen e marrëdhënieve diplomatike.

Bisedimet u zhvilluan në Paris në tri raunde në periudhën mars-qershor-korrik 1985, të alternuara herë në ambasadën e Anglisë dhe herë në atë të Shqipërisë. Delegacioni britanik iu përmbajt propozimit prej 7 pikash, ndërsa delegacioni shqiptar paraqiti 3 pika. Qeveria britanike kërkoi dëmshpërblime në masën 1.9 milionë \$ për incidentin e Kanalit të Korfuzit dhe po kaq edhe për pretendimet financiare të SHBA-së ndaj Shqipërisë.⁵⁹ Këto shuma përfaqësonin 1/3 e vlerës së arit monetar shqiptar. Qeveria shqiptare u tregua e hapur për të filluar bisedimet me palën britanike, por këmbënguli që të fillohej me kthimin e arit monetar Shqipërisë dhe më vonë të diskutohej për pretendimet britanike. Delegacioni britanik në bisedimet e qershorit të vitit 1985, pranoi ta modifikonte klauzolën 4, që kishte të bënte me pagesën e 1.9 milionë \$, që Shqipëria duhej t'i kthente Britanisë së Madhe. Ajo u formulua në mënyrë të tillë, që të mos dukej si pagesë e detyruar nga vendimi i Gjykatës Ndërkombëtare të Hagës për incidentin e Kanalit të Korfuzit.⁶⁰

Delegacioni shqiptar fillimisht e kundërshtoi përfshirjen e kërkesës së amerikanëve për dëmshpërblime në bisedime, duke këmbëngulur se këta të fundit, nuk kishin paraqitur pretendime të tilla në të shkuarën. Si kundërpeshë u përmendën edhe efektet negative të operacionit *Rollback*, të organizuar e drejtuar nga CIA dhe MI6 në vitet 1948-1954 në Shqipëri. Kryetari i delegacionit britanik, John Allan Birch (drejtues i Departamentit të Europës Lindore në FCO) dha sqarime për këtë çështje, duke vënë në dukje se, kërkesa për kompensime kishte dalë nga Kongresi amerikan në vitin 1974 dhe nuk i kushtohej posaçërisht Shqipërisë, por të gjithë atyre vendeve të Europës e botës, që kishin probleme të kësaj natyre me SHBA-në. Sipas shpjegimeve të përfaqësuesit britanik, rreth 2000 shtetas amerikanë me origjinë shqiptare, të larguar nga Shqipëria

⁵⁹ *AMPJ*, V. 1985, D. 1160, 1161, 1162. Relacione të ministrit të Jashtëm të Shqipërisë, Reiz Malile, drejtuar Ramiz Alisë, Adil Çarçanit dhe Sofokli Lazrit në vitin 1985, mbi bisedimet e delegacionit shqiptar me delegacionin britanik në Paris. Shih gjithashtu: procesverbalet e tri takimeve të mbajtura në periudhën mars, qershor dhe korrik 1985; *Po aty*, V. 1982, D. 1214. Studim i Piro Vitos, “Çështja e arit monetar shqiptar të grabitur nga nazistët gjermanë gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe të bllokuar padrejhtësisht nga imperialistët anglezë”, 165 faqe.

⁶⁰ *Po aty*, V. 1985, D. 1160, fl. 100. Informacion i Reiz Maliles për Sofokli Lazrin, 12 qershor 1985.

para Luftës së Dytë Botërore ishin prekur nga shtetëzimet pa shpërblim të pronave të tyre, të cilat ishin përdorur për një periudhë gati 40-vjeçare nga shteti shqiptar. Si rezultat, qeveria amerikane urdhëroi përfaqësuesin e vet në Komisionin Trepalësh, që t'i refuzonte kërkesat e vendeve pretenduese për kthimin e arit monetar, pa marrë më parë kompensime prej tyre. Qeveria amerikane kishte mbi 10 vjet që i përmbahej këtij qëndrimi, por për shkak të mungesës së kontakteve ajo nuk ia kishte bërë të njohur zyrtarisht qeverisë shqiptare.⁶¹ Ky problem ishte diskutuar në Departamentin e Shtetit që në vitet '70, kur flitej për rivendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Shqipërinë. Shifrat e parashikuara që do t'i kërkoheshin Shqipërisë në këtë kohë, e tejkalonin disa herë shumë e pretenduar në mesin e viteve '80, dhe atë çka ata morën realisht në vitet '90. Sipas projekteve të qeverisë amerikane në fillim të viteve '70, Shqipëria duhej ta dëmshpërblente SHBA-në me rreth 2 milionë dollarë amerikanë, për dëmet që kishin pësuar pronat e shtetasve shqiptaro-amerikanë gjatë Luftës së Dytë Botërore, dhe 10 milionë dollarë të tjerë, për të kompensuar vleftën e pronave të shtetëzuara nga regjimi komunist në vitet e para të pasluftës.⁶² Duhet përmendur se, disa diplomatë shqiptarë në Europë dhe në SHBA, kishin pasur dijeni për pretendimet amerikane së paku që nga viti 1979-1980, të cilat ia kishin bërë të njohura edhe Ministrisë së Punëve të Jashtme. Qeveria shqiptare gjykonte se pretendimet financiare të qeverisë amerikane nuk duhej që ta kushtëzonin kthimin e arit monetar Shqipërisë. Por përfaqësuesit amerikanë në Komisionin Trepalësh nuk e lejonin kthimin e arit, pa përmbushur pretendimet e saj financiare. Në këto rrethana, delegacioni shqiptar e tërhoqi refuzimin ndaj pretendimeve të SHBA-së, por kërkoi që ato të dokumentoheshin prej saj. Nga ana tjetër, ai paraqiti pretendimet e Shqipërisë për dëmshpërblime nga qeveria amerikane, për pronat e shqiptaro-amerikanëve dhe pagesën e pensionet e papaguara, por pa i shoqëruar me dokumentacionin përkatës.

Qëndrimi pa kompromis i delegacionit shqiptar, që së bashku me arin monetar, t'i ktheheshin edhe interesat nuk çonte në zgjidhjen e problemeve.⁶³ Në ato rrethana ai bëri një tërheqje taktike dhe e modifikoi

⁶¹ *Po aty*, V. 1985, D. 1162, fl. 25-26.

⁶² *NARA*, RG 59. Memorandum i Departamentit të Shtetit, "Perspektiva e normalizimi të marrëdhënieve me Shqipërinë", 8 mars 1972; *AMPJ*, V. 1978, D. 506, fl. 35-39. Radiogram i ambasadës shqiptare në Beograd për MPJ-në, 17 nëntor 1978.

⁶³ K. Krisafi, *Në kërkim të arit*, 177-180.

qëndrimin e vet, duke propozuar, që, *së pari*, t'i kthehej ari monetar Shqipërisë; *së dyti*, të diskutoheshin pretendimet financiare të Britanisë së Madhe, të SHBA-së, por edhe kompensimi i mundshëm i Shqipërisë, për shkak të dëmeve që i ishin shkaktuar ekonomisë së saj nga bllokimi i arit. Pas zgjidhjes së këtyre çështjeve, do të fillonin bisedimet për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet të dyja vendeve.⁶⁴ Por delegacioni britanik shfaqti mosbesim. John Birch, në bisedë të lirë u shpreh: “Ta themi hapur, ne nuk kemi besim. Ne dyshojmë se qeveria shqiptare do të marrë arin dhe nuk do t'i vazhdojë më tej bisedimet për çështjet e tjera”.⁶⁵ Në raundin e fundit të bisedimeve (23-26 korrik 1985), delegacioni shqiptar kaloi nga një situatë disi premtuese, në bllokimin e bisedimeve, kur kërkoi pjesën e fitimit të munguar nga ari i bllokuar dhe paraqiti kërkesën për dëmshpërblime ndaj qeverisë amerikane.⁶⁶ Ai e kushtëzoi rivendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Britaninë e Madhe, jo vetëm me kthimin e arit monetar, por edhe të interesave të krijuar në vite si fillësë të çdo gjëje. Me gjithë fleksibilitetin e delegacionit britanik, tri raundet e bisedimeve të vitit 1985 (mars-korrik) përfunduan pa rezultat. Delegacioni shqiptar, siç dëshmon një nga anëtarët e tij, prof. Ksenofon Krisafi “dështoi në mënyrë të suksesshme”.⁶⁷

Negociatat shqiptaro-britanike me nxitjen e palës shqiptare vazhduan në mënyrë sporadike në New York në vitin 1987 dhe më 1988. Britanikët përfaqësoheshin sërish nga John Birch (tashmë zëvendëspërfaqësues i përhershëm i Britanisë së Madhe në Kombet e Bashkuara dhe zëvendësministri i Jashtëm i Shqipërisë, Muhamet Kapllani. Në bisedime morën pjesë edhe këshilltari i Misionit britanik në Kombet e Bashkuara, David Eduarts dhe përfaqësuesi i Shqipërisë në këtë organizëm, Bashkim Pitarka. Propozimi i përfaqësuesve shqiptarë përmbante një element të ri për kapërcimin e mosmarrëveshjeve: kthimin njëherësh të arit monetar dhe vendosjen e marrëdhënieve diplomatike.

⁶⁴ AMPJ, V. 1987, D. 1169, fl. 1-4. Informacion i Byrosë Juridike “Mbi bisedimet me anglezët për kthimin e arit shqiptar”, 12 shkurt 1987.

⁶⁵ Po aty, V. 1985, D. 1161, fl. 2. Relacion i Reiz Maliles drejtuar Ramiz Alisë dhe Adil Çarçanit, 23 mars 1985.

⁶⁶ Po aty, V. 1985, D. 1162, fl. 138-142. Informacion i Reiz Maliles për Byronë Politike, 3 gusht 1985.

⁶⁷ K. Krisafi, *Në kërkim të arit*, 254.

Pas këtij hapi do të diskutohej për problemet e tjera të kontestueshme.⁶⁸ Përfaqësuesi britanik kërkoi garanci me shkrim për përmbushjen e pretendimeve financiare të paraqitura nga Anglia dhe SHBA-ja, pa të cilat nuk mund të flitej as për kthimin e arit dhe as për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike. Por Muhamet Kapllani e konsideroi ndërhyrjen e Birch-it, ‘si vendosjen e karrocës para kalit’, ndërsa përfaqësuesi britanik i irrituar u shpreh, ‘ju e vini karrocën para kalit, por këto janë karroca e kuaj të ndryshëm’.⁶⁹ Qeveria shqiptare pothuajse i la mënjanë pretendimet financiare të qeverisë amerikane.

Tratativat e viteve 1987-88 shënuan në fakt, hapa mbrapa në krahasim me ato të vitit 1985. Bisedimet nuk e zgjidhën dot rrethin vicioz dhe ngërçin dhjetëra vjeçar. Qeveria britanike në këto vite ishte më e interesuar se qeveria shqiptare për rivendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Shqipërinë, ndërsa qeveria shqiptare kishte vendosur në plan të parë kthimin e arit monetar - problem që nuk zgjidhej pa përmbushur e garantuar pretendimet financiare të SHBA-së. Në takimet e datave 28 shtator, 15 tetor dhe 18 nëntor 1987, palët ranë dakord që të bisedohej edhe për pretendimet financiare të SHBA-së, ndërsa në takimet e 11 janarit dhe 28 shkurtit 1988 ato nuk u përmendën.⁷⁰ “Sikur mos të mjaftonte kjo, - shkruan Ksenofon Krisafi, - në propozimin shqiptar ishte shtuar edhe një pikë tjetër, për kërkesat pasurore shqiptare ndaj Britanisë së Madhe”.⁷¹ Ky qëndrim sfidues e asfiksues, shkruan prof. Krisafi “ishte përpunuar në zyrat e aparatit të KQ të PPSH, nga njerëz me pushtet në strukturat partiake e shtetërore vendimmarrëse të asaj kohe, të cilëve iu mungonte formimi i duhur profesional, kultura e nevojshme juridike, dijet dhe përvoja diplomatike”.⁷² Autori i strategjisë së tërheqjes, sipas tij, ishte në fakt këshilltari politik i Ramiz Alisë, Sofokli Lazri. Ndërsa vetë Ramiz Alia, deklaronte në Kongresin e 10-të të Bashkimeve Profesionale të Shqipërisë: “Ne jemi për normalizimin e marrëdhënieve edhe me Anglinë. Në qoftë se në Londër do të çlirohen nga paragjykimet që la lufta e ftohtë dhe do të nisen nga dëshira e vullneti i mirë për t’i çbllokuar marrëdhëniet anglo-shqiptare, për gjendjen e të cilave nuk kemi

⁶⁸ AMPJ, V. 1987, D. 1169, fl. 1-4. Relacion i Bashkim Pitarkës për Ministrinë e Punëve të Jashtme, 17 tetor 1987.

⁶⁹ *Po aty*.

⁷⁰ K. Krisafi, *Në kërkim të arit*, 269.

⁷¹ *Po aty*, 270.

⁷² *Po aty*, 264.

faj e asnjë përgjegjësi, në Shqipëri do të gjejnë gatishmëri për të biseduar e bashkëpunuar në frymë konstruktive”.⁷³

Situata do të ndryshonte në fund të viteve '80 dhe sidomos në fillim të viteve '90, me revolucionet demokratike që ndodhën në vendet e Europës Lindore e Qendrore dhe në Bashkimin Sovjetik. Shqipëria ishte vendi i fundit komunist që e braktisi 'bunkerin' komunist dhe u hapi rrugën ndryshimeve demokratike. Në bisedimet shqiptaro-britanike, të zhvilluara në vitin 1990 në New York, Romë e në Gjenevë do të kapërcehej ngërçi gati 50-vjeçar dhe më 29 maj 1991 do të rivendoseshin marrëdhëniet diplomatike me Anglinë.⁷⁴ Përfundimisht në bisedimet e Romës të majit të vitit 1992, palët ranë dakord për zgjidhjen e çështjeve të kontestueshme. Britania e Madhe ashtu edhe SHBA-ja morën paraprakisht garancitë e nevojshme nga qeveria shqiptare për zgjidhjen e pretendimeve të tyre shumëvjeçare. Problemi i arit monetar shqiptar dhe i pretendimeve financiare britanike e amerikane me Shqipërinë, do të kërkonte bisedime të tjera të karakterit teknik në të ardhmen. Pretendimet e të dyja palëve u zgjidhën përfundimisht në vitet 1996-1998.⁷⁵ Zgjidhja u bë në përputhje të plotë me skemën e përcaktuar nga të dyja vendet perëndimore, në rrethana komplet të ndryshme nga ato të viteve '70-'80. Shqipërisë iu kthye pjesa e arit monetar të mbetur, pas përmbushjes së pretendimeve financiare të SHBA-së e Britanisë së Madhe, por pa interesat e pretenduar prej saj në vitet '80.

Bibliografi:

Arkiva:

The National Archives and Record Administration (NARA)

The National Archives, London (TNA)

Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme (AMPJ)

Vitet 1946, 1959, 1965, 1980.

Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (AQSH)

⁷³ *Zëri i Popullit*, Tiranë, 26.06.1987.

⁷⁴ TNA, FCO 973/677, fl. 7. “Lëvizja e Shqipërisë drejt Demokracisë”, janar 1992; K. Krisafi, *Në kërkim të arit*, 281-321.

⁷⁵ K. Krisafi, *Në kërkim të arit*, 363-375; Hamit Kaba, “Përpyqje për afrim: Marrëdhëniet e Shqipërisë me SHBA dhe Anglinë në vitet 1970-1980”, *Studime historike*, nr. 3-4 (2016): 233.

Botime dokumentare:

Hoxha, Enver. *Raport mbi veprimtarinë e Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, mbajtur në Kongresin e 8-të të PPSH-së*, 1 nëntor 1981. Tiranë: 8 Nëntori, 1981.

Literaturë historiografike:

Aldrich, Richard J. *The Hidden Hand, Britain, America, and Cold War Secret Intelligence*. London: John Murray, 2001 (New York: Peter Mayer Publishers, 2002).

Bethell, Nicholas. *The Great Betrayal: untold story of Kim Philby's biggest coup*. London: Hodder and Stoughton, 1984.

Bethell, Nicholas. *The Albanian operation of the CIA and MI6, 1949-1953: conversations with participants in venture Betrayed*. London: 2016.

Bland, William & Ian Price. *A Tangled Web: A History of Anglo-American Relations with Albania (1912-1955)*. London: The Albanian Society, 1986.

Dorril, Stephen. *MI6, Fifty years of special operations*. London: Fourth Estate Limited Boulter 2000.

Freedman, Lawrence. "The Confrontation of the Superpowers, 1945-1990". In *The Oxford History of Twentieth Century*. Edited by Michael Howard and W. Roger Louis. New York: Oxford University Press, 1988.

Gaddis, John Lewis. *George F. Kennan: An American Life*. New York: The Penguin Press, 2011.

Grose, Peter. *Operation Rollback: America's Secret War behind the Iron Curtain*. Boston: Houghton Mifflin, 2000.

Kaba, Hamit. *Shqipëria dhe të Mëdhenjtë: nga Lufta e Dytë Botërore në Luftën e Ftohtë*. Tiranë: KLEAN, 2015.

Kissinger, Henry. *Diplomacia*. Përktheu Petraq Pojani. Tiranë: Laert, 1999.

Krisafi, Ksenofon. *Në kërkim të arit, historia e arit shqiptar të rrëmbyer gjatë Luftës së Dytë Botërore*. Tiranë: UET Press, Dita 2000, 2008.

Macintyre, Ben. *A spy among friends, Kim Philby and the Great Betrayal*. New York: Crown Publishers, 2014.

Gazeta e revista:

Zëri i Popullit, Tiranë, 1974, 1979.

The Times, London, 1978.

HAMIT KABA

Institute of History/ Academy of Sciences of Albania
hamitkaba@yahoo.com

S u m m a r y

THE EFFORTS OF GREAT BRITAIN TO NORMALIZE THE RELATIONS WITH
ALBANIA IN THE LAST DECADES OF THE XX CENTURY

The article focuses on Great Britain's efforts to restore diplomatic relations with Albania during the last two decades of the 20th century. For writing this article the author relied on various sources, where the British archival documents of *The National Archives*, predominate. The main characteristic of this period is the new approach of the British government to this issue, which, unlike over two previous decades, took the first initiative to restore diplomatic relations with Albania and to overcome the deadlock created by the unresolved problems between two countries. However, British flexibility was not accompanied by the elasticity of the Albanian government. The latter remained "captive" of old legal and ideological formulas and Party political orders. The reasons for the new approach of Great Britain have been sought and argued in the great political changes that took place in Europe in the 70s; in the partial changes in Albania's foreign policy after its withdrawal from the Warsaw Treaty; in the new policy of the USA towards Albania; to the situation created after the latter's separation with China and the risk of Albania's re-inclusion in the Warsaw Treaty, etc. The restoration of diplomatic relations with Albania, in the FCO, was judged first and foremost as Great Britain's contribution to Western interests. Western countries, especially Great Britain and the USA, saw the rapprochement with Albania as an opportunity to keep the latter out of the sphere of influence of the Soviet Union. The culmination of efforts to restore diplomatic relations was marked by the bilateral talks, that took place in Paris in 1985. But they also failed "successfully", as a member of the Albanian delegation writes. Relations were restored on May 29, 1991, after Albania abandoned the communist "bunker".

